

**PROCESVERBAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR
“DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PYJORE NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE UNGREJ”**

I mbajtur me datë 18.10.2023 në orën 10:00 në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Lacaj” Lezhë në vijim të njoftimit të publikuar në Web me datë 27 Shtator 2023, përkatësisht në linkun <https://lezha.gov.al/konsultim-publik-per-dhenien-ne-perdorim-te-siperfaqes-pyjore-ne-njesine-administrative-ungrej/>

Takimi u hap nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili në fjalën e tij evidentoi rëndësinë e këtij konsultimi publik të iniciuar nga Bashkia Lezhë, konkretisht nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve dhe diskutimin e kësaj çështje me faktorët lokal.

Prezantimi dhe trajtimi i çështjes u bë nga Z.Artan Palushi përgjegjës në Njesinë e Administrimit të Pyjeve.

Sipas një procesi të filluar nga viti 2007-2008 pyjet konsiderohen pronë e bashkisë. Përveç aktivitetit mbi tokë që është mbulesa bimore, pyjet përdoren për aktivitete të ndryshme si qëllime biznesi, kampinge etj. prandaj është menduar që kjo sipërfaqe të përdoret edhe për qëllime të tjera. Pas studimeve përkatëse është menduar që kjo pronë të jetë në funksion të biznesit për ndërtimin e një parku fotovoltaiq për vendosjen e paneleve diellore. Qëllimi i konsultimit është marrja në konsideratë e mendimeve të komunitetit bazuar edhe në respektimin e udhëzimeve të Ministrisë. Udhëzimi Nr.1 datë 09.06.20216 i Ministrisë së Mjedisit i cili përcakton rregullat, procedurat e kërkimit, shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor, në pikën 7 të këtij udhëzimi theksohet se personat fizikë/juridikë publikë ose privatë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në sipërfaqet e fondit pyjor ose kullosor në administrim të bashkisë, mund të paraqesin në çdo kohë kërkesën në formën e propozimit të pa kërkuar. Në këtë rast kemi të bëjmë me një kërkesë të depozituar nga subjekti “Gjoni Kalivaç” me administrator Z.Gjovalin Gjoni. Pas shqyrtimit të kërkesës është hartuar raporti teknik mbi të cilin është përcaktuar sipërfaqja në përdorim, është marrë në shqyrtim pozicioni gjeografik për të shqyrtuar përshtatshmërinë për funksionet e parashikuara.

Rezulton se kjo sipërfaqe i plotëson të gjitha kriteret, pozicioni, vendodhja etj. Nga informacioni që disponojmë në këtë sipërfaqe mungon bimësia dhe të tilla sipërfaqe janë objekt që të përdoren për funksione të tjera duke zhvilluar biznesin dhe gjeneruar të ardhura. Pas këtij konsultimi procedurat do kalojnë në Këshill Bashkiak për miratim.

Mendime/Diskutime

1. Në atë zonë nuk ka pasur asnjëherë bimësi, është tokë që nuk ka prodhim dhe që ka degraduar.
2. Bazuar në përbërjen e asaj toke, bimësia është shumë e ulët dhe është e pamjaftueshme të përdoret edhe për blegtori prandaj një iniciativë e tillë do ndikonte në zhvillimin e zone, për këtë arsye dakordësohemi për shfrytëzimin e kësaj sipërfaqe për qëllimin e diskutuar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak citoi se shfrytëzimi i sipërfaqeve të tokës të cilat nuk kanë prodhimtari është iniciativë e vlefshme jo vetëm për biznesin por fakti që shfrytëzimi i energjisë së diellit, energjisë së erës është pozitive edhe për mjedisin.

3. Në këtë rast kërkesa është formalitet, zona aty quhet “Boka e Gjonit” është zonë pa gjelbërim dhe nuk besoj që ka komunitet që është kundër zhvillimit të këtij niveli.
4. Shpresojmë që biznesi të ketë fuqi për ta realizuar këtë projekt sepse kërkon shumë angazhim, kosto etj.

Në përfundim të diskutimeve takimi u mbyll nga Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Mbajti Procesverbal

Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve

Artan Palushi



